

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Trashëgimia'/ Goditet rrjeti ndërkombëtar i kokainës Brazil–Europë, trafikuan 4.6 ton drogë
ADRESA	https://piranjat.al/bota/trashegimia-goditet-rrjeti-nderkombetar-i-kokaines-brazileurope-trafficuan-4-i104754
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHÀ


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 21:51:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 21:45:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d647c10ad13809109e89eb0e8c1956554606689aec3222bb76deb37c27ed13df
TEKSTI	4328b0172f82d3fbd293294e1f4b20effd231ce9188c7a4baa231aa4e4c43c4b
PAMJA	e609a625286f339fd6218c83db7c25edfedb75c1dfc4546aba7b980bd791d79a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5853bb2bee5e103bd6897f54e1918d943e06ab926b4510cf9ad1a9f38d0d05ac
E MËPARSHMJA	7cbff7996f531e1bec229ffdf12062b5e52ec6241e6a20e15631de28bdf29329
RRËNJA MERKLE	6fb9c5db00d56eb16d7b89509f6753e0d73cfa2b6c12b8ba1cfb6a7dfb21a7a6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5853bb2bee5e103bd6897f54e1918d943e06ab926b4510cf9ad1a9f38d0d05ac>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [me grushte karriqe](#) ■ [Siq shihet nga videoja re](#) ■ [Zbardhet dinamika](#) rrugor në rrugën Poseidonos ■ [është kaq strategjike](#) zementi, në Gadishullin Arabik, dhe ■ [1: Lironi çunat](#) në 1. Pasi në këtë komisarjat mb ■ [u godit banda e](#) e cila e kishte qendrën në Katalonia ■ [reprezentat](#)

[BOTA](#)

'Trashëgimia'/ Goditet rrjeti ndërkombëtar i kokainës Brazil–Europë, trafikuan 4.6 ton drogë

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 23:45



Një strukturë kriminale transnacionale, e dyshuar për trafikimin e sasive të mëdha të kokainës nga Amerika e Jugut drejt Europës, është vënë në shënjestër të një operacioni të përbashkët të autoriteteve braziliane dhe italiane.

Operacioni, i koduar “Trashëgimia” (“Eredità”), është zhvilluar nga Policia Federale braziliane në bashkëpunim me Karabinierët e ROS të Italisë. Në fokus të hetimit janë dërgesat e kokainës përmes portit të Paranaguá, me destinacion disa vende europiane, përfshirë Italinë.

Në kuadër të aksionit janë ekzekutuar 8 masa sigurie dhe janë kryer 5 kontrolle e sekuestime. Autoritetet kanë vendosur gjithashtu masa pasurore, përfshirë sekuestrimin e pasurive të paluajtshme dhe ngrirjen e llogarive bankare, investimeve dhe mjeteve të tjera financiare.

Mbi 4.6 tonë kokainë janë lidhur me hetimin. Bëhet fjalë për të paktën 11 sekuestime të kryera gjatë viteve 2019 dhe 2020, me ngarkesa që, sipas hetuesve, kishin destinacion Italinë, Belgjikën, Holandën, Francën dhe Portugalinë.

Në mesin e sasive të hetuara është edhe një ngarkesë prej rreth 2.2 tonësh kokainë, e cila ndodhej në Brazil në momentin e arrestimeve të vitit 2019 dhe që, sipas hetuesve, më pas do të ishte lëvizur nga struktura kriminale e riorganizuar.

Një nga elementet kryesore të hetimit është dyshimi se aktiviteti kriminal vazhdoi edhe pas arrestimeve të vitit 2019. Sipas autoriteteve, pas arrestimit në Praia Grande, në shtetin e São Paulos, të dy personave të lidhur me mafian italiane, familjarë dhe persona të besuar morën gradualisht role strategjike në strukturë.

Hetuesit dyshojnë se rrjeti ruajti kontaktet me furnizuesit e narkotikëve, sistemet logjistike dhe mekanizmat financiarë të përdorur për transportimin e kokainës drejt Europës.

Kjo vazhdimësi qëndron në thelb të emrit “Trashëgimia”. Sipas rindërtimit hetimor, aktiviteti kriminal nuk u ndërpre pas goditjeve të para, por dyshohet se u përshtat dhe kaloi në duart e personave të tjerë të lidhur me strukturën.

Hetimi ka nxjerrë gjithashtu në pah një strukturë financiare ndërkombëtare të dyshuar për lëvizjen dhe fshehjen e të ardhurave nga trafiku i drogës. Në fokus kanë qenë transferimet ndërkombëtare të parave, ndërmjetës financiarë, kompani fiktive, investime në pasuri të paluajtshme dhe blerje të mallrave me vlerë të lartë.

Personat e përfshirë dyshohet se përdorin edhe platforma komunikimi të koduara, me sisteme që synonin të vështirësonin punën e hetuesve.

Operacioni “Trashëgimia” është pjesë e një hetimi shumëvjeçar dhe lidhet me operacionet e mëparshme “Retis”, “Spiderweb”, “Samba” dhe “Mafiusi”.

Bashkëpunimi mes Italisë dhe Brazilit është zhvilluar përmes një Ekipi të Përbashkët Hetimor (JIT), ku nga pala italiane janë përfshirë Karabinierët e ROS, Prokuroria e Torinos dhe Drejtoria Kombëtare Antimafia dhe Antiterrorizëm. Nga pala braziliane kanë marrë pjesë Policia Federale dhe Prokuroria Publike Federale.

Personat nën hetim mund të përballeshin, në varësi të përgjegjësisë individuale, me akuza për trafik ndërkombëtar narkotikësh, organizim kriminal me qëllim trafikun e drogës dhe pastrim parash, si dhe vepra të tjera që mund të dalin gjatë hetimit.

Operacioni nxjerr në pah dyshimin e autoriteteve se një strukturë kriminale mund të vazhdojë aktivitetin edhe pas arrestimit të figurave kryesore, duke ruajtur lidhjet, rrugët e trafikut dhe mekanizmat financiarë nga Brazili drejt Europës.

Artikulli të sugjeruar

Artikuj të sugjeruar

BOTA 17 Shtator23:27

[**Tmerri i incestit/ Nënë 46-vjeçare pranon se ka kryer marrëdhënie seksuale me djalin “vetëm 100 herë”**](#)

Një nënë e martuar dhe djali i saj janë akuzuar për incest, pasi ajo pranoi se të dy kishin kryer marrëdhënie seksuale &...

BOTA 17 Shtator22:49

[**Presidentit iranian i lejohet hyrja në SHBA!**](#)

SHBA-ja u jep viza zyrtarëve iranianë për Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB). Shtetet e Bashkuara kanë...

BOTA 17 Shtator22:43

[**VIDEO/ Droni rus godet anijen turke në Ukrainë, viktima dhe të plagosur**](#)

Një anije mallrash në pronësi turke është goditur nga një dron rus në një kanal të Deltës së Danubit, në...

BOTA 17 Shtator21:29

[**I veshur si grua, 33-vjeçari ‘tradhohet’ dhe arrestohet! Para agjentëve bën dëshminë tronditëse për numrin e vrasjeve, i treti në histori**](#)

Ai pothuajse ia kishte dalë, por një tatuazh e tradhtoi. Jordan Lopes da Silva, 33 vjeç, ishte maskuar si grua, duke vendosur një paruke, ...

BOTA 17 Shtator21:23

[**“Eliminoheni pa lënë gjurmë”/ Historia e vrasjes së Georgi Markovit me çadrën e helmuar**](#)

Një nga vrasjet më të pazakonta politike të Luftës së Ftohtë ndodhi në Londër më 7 shtator 1978, kur shkrimtar...

BOTA 17 Shtator21:18

[**Çfarë është “Porta e Lotëve” dhe pse është kaq strategjike për botën?**](#)

Ku ndodhet Bab el-Mandeb? Ngushtica e Bab el-Mandeb ndodhet midis Jemenit, në Gadishullin Arabik, dhe brigjeve afrikane të Xhibutit dhe Eritresë...

BOTA 17 Shtator21:01

[**5 skenarë në lojë, Friedrich Merz rrezikon shkarkimin këtë fundjavë!**](#)

Kancelari gjerman Friedrich Merz përballët me rrezikun e largimit nga posti që këtë fundjavë, vetëm 16 muaj pasi mori detyrën...

BOTA 17 Shtator20:53

[**Tensionet në ngushticën Bab al-Mandeb, Meloni urdhëron Marinën për mbrojtjen e anijeve italiane**](#)

Italia ka aktivizuar Marinën Ushtarake për të përgatitur masat e nevojshme për mbrojtjen e anijeve italiane që kalojnë në...

BOTA 17 Shtator20:01

[**OKB: SHBA ka të ngjarë të ketë kryer krime lufte në Iran, përfshirë shkollën në Minab**](#)

Një mision i pavarur faktmbledhës i mandatar nga Kombet e Bashkuara ka arritur në përfundimin se ekzistojnë “baza të arsyes...

BOTA 17 Shtator19:29

[**Erdogan kërkon një mandat të ri presidencial? Çfarë thotë këshilltari i tij për zgjedhjet e parakohshme**](#)

Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan pritet të kërkojë një mandat të ri presidencial në zgjedhjet e parakohshme në Turqi, të...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 17 Shtator

[**Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...**](#)

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policisë&e...

SHOWBIZ 17 Shtator

[**Susan Sarandon zbulon pse nuk u martua me Tim R...**](#)

Susan Sarandon dhe Tim Robbins kaluan 23 vite së bashku, rritën dy fëmijë dhe për shumë kohë u konsideruan një nga &cc...

AKTUALITET 17 Shtator

[Operacion antidrogë në Korçë, arrestohen 3 të r...](#)

Finalizohet një operacion antidrogë në Korçë, në kuadër të të cilit janë arrestuar tre persona dhe jan&eum...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

video




E premte | ? 20:45 | Syri TV






E premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premtë | ? 20:45 | ??? Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.